

Çfarë është
Selefizmi

Shejh
ABDULLAH IBN ABDURRAHIM
EL-BUHARI

e

ÇFARË ËSHTË SELEFIZMI

Leksion i mbajtur nga Shejhu i Nderuar

Dr. ABDULLAH IBN ABDURRAHIM EL-BUHARI

Përktheu: AbdusSamed V.Meta

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit

Të gjithë lavdërimet i takojnë Allahut. Vetëm Atë e lavdërojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë e falje kërkojmë. Kërkojmë mbrojtje tek Allahu nga sherret e veteve tona dhe nga të këqijat e veprave tona. Atë që e udhëzon Allahu, nuk ka kush që ta humbasë dhe atë që e humb Allahu, nuk ka kush që ta udhëzojë.

Dëshmoj se nuk ka të adhuruar me të drejtë, përveç Allahut, të vetëm, pa ortakëri në adhurimin e Tij, dhe dëshmoj se Muhamedi është Robi dhe i Dërguari i Tij, lëvdata dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, familjen dhe shokët e tij.

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ حَقَّ تَقَاتِهِ وَلَا تَمُوتُنَّ إِلَّا وَأَنتُمْ مُسْلِمُونَ ١٠٢﴾

“O ju që keni besuar! Kijeni frikë Allahun, sinqerisht, duke iu përmbajtur me të gjitha fuqitë në bindje të Tij, dhe mos vdisni ndryshe, veçse duke qenë muslimanë (në fenë e pranuar tek Allahu, Islamin)!” Al-Imran, 102.

﴿يَا أَيُّهَا النَّاسُ اتَّقُوا رَبَّكُمُ الَّذِي خَلَقَكُمْ مِنْ نَفْسٍ وَاحِدَةٍ وَخَلَقَ مِنْهَا زَوْجَهَا وَبَثَّ مِنْهُمَا رِجَالًا كَثِيرًا وَنِسَاءً وَاتَّقُوا اللَّهَ الَّذِي تَسَاءَلُونَ بِهِ وَالْأَرْحَامَ إِنَّ اللَّهَ كَانَ عَلَيْكُمْ رَقِيبًا ۝١﴾

“O ju njerëz! Frikësohuni Zotin tuaj (adhurojeni Atë të vetëm pa ortakëri), i Cili ju ka krijuar nga një njeri i vetëm (Ademi alejhis-selam), dhe prej tij krijoi bashkëshorten e tij (Hauan, nga brinja e tij e majtë), e prej atyre të dyve krijoi shumë burra e gra. Dhe frikësohuni Allahut që për hir të Tij ju kërkoni prej njëri-tjetrit, e në ruajtjen e lidhjeve me të afërmit. Allahu është Mbikëqyrësi mbi ju (i veprave dhe i gjendjeve tuaja).” En-Nisa, 1.

﴿يَا أَيُّهَا الَّذِينَ ءَامَنُوا اتَّقُوا اللَّهَ وَقُولُوا قَوْلًا سَدِيدًا ۝٧٠ يُصْلِحْ لَكُمْ أَعْمَالَكُمْ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ وَمَنْ يُطِيعِ اللَّهَ وَرَسُولَهُ فَقَدْ فَازَ فَوْزًا عَظِيمًا ۝٧١﴾

“O ju që keni besuar! Frikësohuni Allahut (veproni të urdhëruarën e largohuni të ndaluarës) dhe thoni fjalën e drejtë (për Allahun, - fjalën La ilahe il-lAllah, - thoni fjalën e vërtetë për të Dërguarin, për sahabët dhe për pasuesit e tyre). (E nëse ecni në këtë atëherë do të keni premtimin e Tij;) Ai do t’ju drejtojë veprat tuaja e do t’ju falë gjynahet tuaja. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ai ka arritur suksesin e madh.” Al-Ahzab, 70-71.

Dhe më pas: Fjala më e drejtë është Libri i Allahut. Udhëzimi më i mirë është Udhëzimi i Muhamedit, sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Gjërat më të këqija janë të shpikurat në fe, çdo shpikje në fe është bidat dhe çdo bidat është humbje. Më pas:

Unë e lavdëroj Allahun, i Cili, nuk ka të adhuruar me të drejtë, përveç Tij, të lartë dhe të pastër janë Emrat dhe Cilësitë e Tij, i Madhërishmi në lartësimin e Tij. I Cili përgatiti për ne këtë takim në këtë vend të begatë.

I lutem të Lartë-Madhëruarit të na bëjë të gjithëve prej atyre që e dëgjojnë fjalën dhe e pasojnë më të mirën. Ai është Dëgjuesi, iu Përgjigjet lutjes.

Vëllezër! Njerëzit, para ardhjes së Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, kanë qenë në injorancë dhe marrëzi; në shirk, në padrejtësi dhe humbje. Kështu, Allahu dërgoi zotërinë e njerëzve, Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, në kohën që ishte shkëputur dërgimi, për të drejtuar popullin e shtrembëruar, duke thënë: La ilahe il-lAllah, e për të shpëtuar. Me të erdhi e vërteta dhe u zhduk e kota. Me të erdhi udhëzimi dhe me të erdhi jeta. Me të erdhi drejtësia dhe me të Allahu e zhduk shirkun, ortakërinë në adhurimin e Tij.

Allahu, i Madhëruar në lartësimin e Tij, e dërgoi atë mëshirë për botët. E dërgoi atë përgëzues dhe paralajmërues. Përgëzues për atë që i besoi atij dhe paralajmërues për atë që e kundërshtoi dhe pengoi nga rruga e tij. Allahu, i Madhëruar në lartësimin e Tij, thotë:

﴿يَا أَهْلَ الْكِتَابِ قَدْ جَاءَكُمْ رَسُولُنَا يُبَيِّنُ لَكُمْ كَثِيرًا مِّمَّا كُنْتُمْ تُخْفُونَ مِنَ الْكِتَابِ وَيَعْفُو عَنْ كَثِيرٍ قَدْ جَاءَكُمْ مِنَ اللَّهِ نُورٌ وَكِتَابٌ مُبِينٌ ١٥ يَهْدِي بِهِ اللَّهُ مَنِ اتَّبَعَ رِضْوَانَهُ سُبُلَ السَّلَامِ وَيُخْرِجُهُم مِّنَ الظُّلُمَاتِ إِلَى النُّورِ بِإِذْنِهِ وَيَهْدِيهِمْ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ١٦﴾

“O ithtarë të librit (jehudij e të krishterë)! Ka ardhur tek ju i Dërguari Jonë (Muhamedi), duke ju sqaruar shumë nga ato që i keni fshehur prej librit (i devijuat, i ndryshuat dhe shpifët ndaj Allahut), e i kalon shumë të tjera (sepse nuk ka dobi në sqarimin e tyre). Juve ju erdhi nga Allahu dritë dhe libër i qartë (në çdo gjë që krijesat kanë nevojë për çështjet e fesë dhe dynjasë së tyre).

Allahu udhëzon me të (me Librin), në rrugët e Shpëtuesit (që ligjëroi për robërit, me të cilat dërgoi të Dërguarit e Tij, që është Islami), atë që ndjek kënaqësinë e Tij, dhe i nxjerr ata prej errësirave (të kufrit e të shirkut)

në dritën (e Islamit) me Lejen (suksesin) e Tij dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë.” El-Maide, 15-16.

Imami, Hafidh Ebu Xhaëfer ibn Xherir Et-Taberi, imami i komentuesve të Kuranit, ka thënë në Tefsirin e tij për këtë ajet: “Me “Nur-Dritën” ka për qëllim Muhamedit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, me të cilin Allahu e ndriçoi të vërtetën, shfaqti me të Islamin dhe zhdukuri me të shirkun.

Ai është dritë për atë që ndriçohet me të. Ai është dritë për atë që ndriçohet me të sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Me të qartëson të vërtetën.” Këtu mbaron fjala e tij, Allahu e mëshiroftë.

Imam Buhariu në Sahih transmeton nga Ata’ ibn Saib – Allahu e mëshiroftë – të thotë: E kam takuar Abdullah ibn Amër ibn As radijAllahu anhumas, dhe i thashë: Më trego për cilësinë e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në Teurat.

Po. Pasha Allahun! Ai është cilësuar në Teurat me disa cilësi të tij në Kuran.

﴿يَا أَيُّهَا النَّبِيُّ إِنَّا أَرْسَلْنَاكَ شَهِيدًا وَمُبَشِّرًا وَنَذِيرًا ٤٥﴾

“O i dërguar! Ne të kemi dërguar ty dëshmitar, përgëzues dhe paralajmërues.” Mbrojtës për analfabetët. Ti je rob i Im dhe i dërguari i Im. Të kam quajtur “i mbështeturi tek Allahu”. Nuk je fjalë-ulët dhe as i ashpër. Nuk je grindës nëpër tregje. Nuk e largon të keqen me të keqe. Por, fal. Allahu nuk ia merr atij shpirtin, derisa me të të drejtoi popullin e shtrembër, që të thonë: La ilahe il-lAllah. Kështu, me të hap sy të verbuar, veshë të shurdhër dhe zemra të mbuluar.” Kjo është cilësia e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në Teurat dhe këto janë disa cilësi të tij.

Imam Tirmidhiu në Xhamiun e tij dhe Ibn Maxheh në Sunenin e tij me sened të saktë transmetojnë nga Enesi radijAllahu anhu se ka thënë:

“Ditën kur i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem hyri në Medine ndriçoi në të çdo gjë, kurse ditën që ai vdiq u errësua në të çdo gjë. Dhe kur i shkundëm duart nga dheu tek varrimin i të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, saqë i mohuam zemrat tona.”

“saqë i mohuam zemrat tona”, kjo shprehje - të dashur - shpreh dhimbjen e madhe me humbjen e zotërisë së të dërguarve sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Tek Imam Buhariu në Sahihun e tij transmeton Xhabiri radijAllahu anhu se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ngrihej ditën e Xhuma tek një pemë, apo hurmë. Një grua, apo një burrë nga Ensarët i thotë: O i Dërguari i Allahut! A të bëjmë për ty një minber? Ai tha: ***“Nëse dëshironi.”*** E kështu ata i bënë atij një minber, sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Kur qe dita e Xhuma u drejtua, - e në një shprehje: u ngjit në minber, atëherë hurma filloi të ngashërehej siç bën foshnja. Pastaj, Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem zbriti dhe e shtrëngoi atë. Ajo qetësohet, dhe pushon të qarën e fëmijës. Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tha: ***“U sakrifikoftë babai dhe nëna ime! Ajo qante për shkak të përkujtimit që dëgjonte në të.”***

Imam El-Hasen El-Basri, Allahu e mëshiroftë, ka thënë: O ju muslimanë! Druri përmallohet për të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nga dashuria për takimin me të. Për ju është më hak ta doni atë.

Të dashur! Pas kësaj hyrjeje, leksioni siç e dëgjuat ka temë të gjerë. Ajo është **Çfarë është Selefizmi**, me të cilën erdhi ky Pejgamber bujar sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Që

sapo i dëgjuam disa prej cilësive të tij dhe të udhëzimit të tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Mirëpo, duke qenë se vendi dhe koha nuk mjafton për të sjellë këtë temë në çdo aspekt të tij, kam përzgjedhur një sërë pikash për të folur për të:

Pika e parë: Shpjegimi i kuptimit të fjalës “Selef” nga ana gjuhësore.

Pika e dytë: Kush janë “Selefët” nga ana fetare.

Pika e tretë: Disa emërtime të ligjëruara për Selefus Salih.

Pika e katërt: Gjykimi i pasimit të selefizmit dhe i përkatësisë me të.

Pika e pestë: Vlera e pasimit të Selefëve dhe selefizmit.

Pika e gjashtë: Cilësitë dhe veçoritë dalluese të menhexhit selefi apo selefizmit.

Pika e shtatë: Mbyllja. E mbylltë Allahu për ne dhe për ju me të mirën.

Në të do të jenë disa fjalë ndriçuese, në lidhje me temën.
E Allahut i kërkohet suktesi.

Pika e parë: Qartësimi i kuptimit të fjalës “Selef” nga ana gjuhësore.

E para ndër pikat është në sqarimin e kuptimit të fjalës “Selefi” apo “selefizëmi” nga ana gjuhësore.

Shkronjat “sin”, “lam” dhe “fa” janë origjinë e cila tregon për të parën, të përparmen. Prandaj, fjala “selef” në gjuhë ka kuptim: paraardhës, i parë. Shumësi i saj është “saalif”, “eslafin”, “sulufin” dhe “sul-laf”. Përdoret për këdo që ka qenë para teje, qoftë lidhje farefisnore, e të ngjashme. Në këtë kuptim është fjala e të Madhëruarit në lartësimin e Tij:

﴿فَجَعَلْنَاهُمْ سَلَفًا وَمَثَلًا لِّلْآخِرِينَ ٥٦﴾

“Ne i bëmë ata paraardhës dhe shembull për ata pas tyre.” Ez-Zuhruf, 56.

Imam Begauiu në Tefsirin e tij për këtë ajet thotë: Selefi; janë ata që kanë kaluar para prej baballarëve. Pra i bëmë të parë, në mënyrë që të këshillohen prej tyre të fundit.

Po ashtu, është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿وَأَن تَجْمَعُوا بَيْنَ الْأُخْتَيْنِ إِلَّا مَا قَدْ سَلَفَ﴾

“dhe të bashkoni (përnjëherë në një nikah) dy motra, përveç asaj që ka kaluar më parë.” En-Nisa, 23.

Ka për qëllim: - përveç asaj që ka kaluar më parë nga veprimi juaj, është falur. Përgjyeshimi është për gjynahun dhe jo për lejimin e veprimit. Prandaj dhe thuhet: Filani ka pasur selef bujar; pra, baballarët e parë. **Kështu e thotë Ragib Esfehhanij në “El-mufredat”.**

Hafidh Ibn Ethir dhe i nderuari Ibn Mendhur e kanë veçuar kuptimin e fjalës “selef” duke thënë: Selef janë ata që ishin para teje në moshë dhe në vlera. Prandaj dhe Ibn Mendhuri Allahu e mëshiroftë thotë: Gjithashtu, selef janë ata që kanë qenë para teje prej baballarëve dhe të afërmve, të cilët janë mbi ty në moshë dhe në vlerë. Për këtë dhe janë quajtur brezi i parë prej tabiinëve “Selehus-Salih”, “të parët e mirë”.

Gjithashtu, këtë kuptim e tregon dhe hadithi i Aishes radijAllahu anha në dy Sahihet. Ky hadith ka ngjarje, e cila është: Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i thotë me zë të ulët Fatimes radijAllahu anha, dhe ajo qan. Ai, pasi e sheh, duke u treguar jo e duruar, i thotë me zë të ulët përsëri. Atëherë, ajo qeshi radijAllahu anha. E pyet atë Aishja, por ajo nuk i tregoi asaj. E kur vdiq Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem e pyeti duke ia përsëritur pyetjen. Ajo, radijAllahu anha, i përgjigjet duke thënë: Kur më tha me zë të ulët herën e parë, më lajmëroi se Xhibrili ia mësonte Kuranin një herë në çdo vit, dhe tani ia ka paraqitur dy herë. Dhe i thotë asaj:

“Unë mendoj se më është afruar exheli! Prandaj, kije frikë Allahun dhe duro! Sepse unë jam selefi më i mirë për ty.” Ajo i thotë: Prandaj dhe kam qarë me atë të qarë siç e pe. Mirëpo, me të parë dhimbjen time më thotë përsëri me zë të ulët, për së dyti:

“O Fatime! A nuk do të pëlqeje të ishe zonjusha e grave të besimtarëve, - apo zonjusha e grave të këtij umeti?!” Ajo i thotë: Prandaj dhe kam qeshur me atë të qeshur siç e pe.

Hafidh Neueuiu, Allahu e mëshiroftë, në Sherhul-Muslim në komentimin e fjalës së Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem thotë: ***“Sepse unë jam selefi më i mirë për ty.”*** Selef është paraardhësi. Kuptimi është: Unë jam para teje, kështu që do të më vish pranë. Të dashur! Ky është kuptimi gjuhësor.

Pika e dytë: Kush janë “Selefët” nga ana fetare.

Sapo kaloi me ne se “selef” nga ana gjuhësore është kushdo para teje, që të ka parakaluar në moshë dhe në vlerë.

Allahu i Lartë-Madhëruari në Librin e Tij thotë:

﴿وَالسَّابِقُونَ الْأَوَّلُونَ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالْأَنْصَارِ وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَنٍ رَّضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ وَأَعَدَّ لَهُمْ جَنَّاتٍ تَجْرِي تَحْتِهَا الْأَنْهَارُ خَالِدِينَ فِيهَا أَبَدًا ذَلِكَ الْفَوْزُ الْعَظِيمُ ١٠٠﴾

“Të mëparshmit, të parët, prej Muhaxhirëve dhe prej Ensarëve dhe prej atyre që i pasuan ata me përsosmëri, Allahu është i kënaqur ndaj tyre (me bindjen që i bënë dhe që iu përgjigjën të Dërguarit) dhe ata janë të kënaqur ndaj Tij (me shpërblimin që morën për bindjen dhe imanin e tyre). Ai ka përgatitur për ta xhennete, nën të cilat rrjedhin lumenj, përgjithmonë do të jenë në to, përjetësisht. Ai është fitimi i madh.” Et-Teube, 100.

Në dy Sahihet nga Ibn Mes’udi radijAllahu anhu se ka thënë: I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem ka thënë: ***“Më të mirët njerëz janë brezi im, më pas ata që vijnë pas tyre, më pas ata që vijnë pas tyre. Pastaj do të vijnë njerëz, që dëshmia e tij do t’i paraprijë betimit të tij dhe betimi i tij do t’i paraprijë dëshmisë së tij.”***

Në Sahihun e Muslimit nga Aishja radijAllahu anha thotë: Një burrë e pyeti të Dërguarin e Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem duke i thënë: Cilët janë njerëzit më të mirë? Ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem iu përgjigj: ***“Brezi në të cilin jam unë, më pas vjen i dyti, më pas vjen i tretë.”***

Në këtë temë ka shumë hadithe. Ajeti që sapo kaloi në suren Teube dhe hadithet që kanë ardhur, e të tjera hadithe dhe argumente, që të gjitha argumentojnë për mirësinë e sahabëve dhe se janë më të mirët e umetit pas të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Pa dyshim e pa mëdyshje, ata janë selefët që na prijnë në vlerë, në dije dhe në iman, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Por këtu është një pyetje e rëndësishme:

A është përcaktimi kohor, - i ardhur në hadithin e Ibn Mes'udit, të Aishes e në të tjera hadithe, - a është përcaktimi kohor i mjaftueshëm për përcaktimin e kuptimit “selef” nga ana fetare? E në një kuptim tjetër:

A është çdokush i cili ka jetuar në atë kohë të begatë, mjafton për të qenë prej selefus-salih, të cilët i ndjekim?

Përgjigjja: Jo, e për këtë të jesh i sigurt. Përse? Sepse koha e parë nuk mjafton për të përcaktuar selefët, por me patjetër duhet shtuar në këtë një kufizues i rëndësishëm. I cili është: Përputhja e tij me Kuranin, me Sunetin dhe me kuptimin e Sahabëve, radijAllahu anhum.

Për këtë dhe i gjejmë imamllarët e Ehli Sunetit ta kufizojnë këtë përkufizim, duke thënë: “Es-Selefus-Salih” “të parët e mirë”, për të qenë jashtë të parët e prishur, që kanë qenë në kohën e tyre, por jo në kuptimin, shembullin dhe rrugën e tyre. E sikurse thuhet: Aktualiteti është dëshmia më e mirë. A nuk dolën kaderijtë?! **Hadithi gjendet tek Sahihu i Muslimit**, e që është hadithi i parë në të. U distanca prej tyre Abdullah ibn Umer radijAllahu anhu. A nuk është kështu?! Ndërkohë që ata gjendeshin në një kohë me sahabët, apo me pjesën më të madhe të sahabëve.

Po kështu, dolën haurixhët kundër Aliut radijAllahu anhu dhe të tjerëve prej sahabëve. Edhe këta ndodheshin në një kohë me sahabët. Saqë, kur Ibn Abasi debatoi me ta, në debatin e njohur, të cilin e ka nxjerrë **Hakimi në Mustedrek dhe të tjerë me sened të saktë**. Prej fjalës që u tha haurixhëve, duke argumentuar me të për humbjen e tyre, është: “Vështro! Nuk gjendet në mesin tuaj prej tyre askush – pra nuk gjendet asnjë sahab në mesin tuaj.” Nuk është në këtë grupimin tuaj, - ndërkohë që ata ishin rreth gjashtë mijë vetë, sikurse është transmetimi tek **Hakimi dhe Bejhakiu**, - Nuk gjendet në mesin tuaj prej tyre askush. Kjo mjafton për të treguar humbjen tuaj.

Atëherë, koha e mëparshme nuk mjafton për të qenë personi prej selefi-salih.

Muslimi në Mukadime të Sahihut ka nxjerrë nga Shekik ibn Seleme - Allahu e mëshiroftë - të thotë: E kam dëgjuar Abdullah ibn Mubarek të thotë para njerëzve:

“Lëreni hadithin e Amër ibn Thabit, sepse ai i ka pas sharë selefët.” “Lëreni hadithin e Amër ibn Thabit, sepse ai i ka sharë selefët.” Këtu qëllimi me selefët janë sahabët, e askush tjetër. Janë sahabët dhe askush tjetër, radijAllahu anhum.

Këtë përkufizim, - kam për qëllim selefizmin - e ka sqaruar një grup i madh dijetarësh, dijetarë të Ehli Sunetit. Vendi nuk mjafton për këtë, por do të tregojmë disa:

Prej tyre është thënia e Imamit të Ehli Sunetit, Imamit të nderuar Ahmed ibn Hanbel - Allahu e mëshiroftë dhe qoftë i kënaqur me të - ku thotë në letrën e tij të njohur “Usulus-Suneh” “Bazat e Sunetit”, ai thotë:

“Bazat e Sunetit tek ne janë: Kapja pas asaj që kanë qenë shokët e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe ndjekja e tyre.”

I nderuari Sefarini - Allahu e mëshiroftë - në “Leuamiul-Enuar” thotë:

“Qëllimi me rrugën e Selefëve është ajo në atë që ishin Sahabët e nderuar - Allahu qoftë i kënaqur me ta - dhe pasuesit e tyre me përsosmëri (tabiinët) dhe pasuesit e tyre dhe imamllarët e fesë, që është dëshmuar për imamllëkun e tyre, është e njohur çështja e tyre e madhe në këtë fe’, dhe njerëzit e kanë marrë fjalën e tyre, pasardhësit transmetuar nga të parët, përveç atij që është quajtur me bidat, apo njihet me një llogar të urryer; si p.sh. haurixhët, rafiditë, kaderijtë, murxhiet, xhebritë, xhehmijet, muëtezilitë dhe kerramijet, e të tjerë si këta.” Këtu mbaron fjala e tij, Allahu e mëshiroftë.

Shejhu ynë, i nderuari Muhamed Eman, Allahu e mëshiroftë dhe e faltë, në librin e tij të madh “Es-Sifatul-Ilahijeh fi dauil-Kitabi ues-Suneh”, “Cilësitë e të Adhuruarit në Dritën e Kuranit dhe të Sunetit” thotë: “Është e qartë nga çka kaloi se kuptimi i “selefizmit” është bërë përkufizim i përdorur për brezin e parë dhe për atë që i ndjek ata në marrjen e dijes dhe në rrugën e kuptimit të tij dhe në metodën e thirrjes për tek ajo. Nuk është i kufizuar në një periudhë kohore të veçantë. Por, është detyrë të kuptohet se ai ka domethënie të vazhdueshme në vazhdimësi të jetës. Dhe është e domosdoshme përkufizimi i grupit të shpëtuar në dijetarët e Hadithit dhe të Sunetit. Këta janë njerëzit e këtij menhexhi, i cili do të jetë i qëndrueshëm deri Ditën e Kijametit, bazuar në fjalën e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

“Do të jetë një grup prej umetit tim i ndihmuar me të vërtetën, nuk iu bën dëm atyre ata që i kundërshtuan e as ata që i braktisën.” Këtu mbaron fjala e tij, Allahu e mëshiroftë.

Unë them se hadithin të cilin ai e përmendi, - Allahu e mëshiroftë, - është mutefekun alejhi nga hadithi i Muauijes, radijAllahu anhu.

Pra, mësuam se kuptimi me “selef” nga ana fetare janë sahabët, tabiinët dhe ata që i pasuan me përsosmëri, deri Ditën e Gjykimit, ai që ecën në rrugën e tyre dhe ndjek gjurmët e tyre.

Të dashur! Pika e tretë: Disa emërtime të ligjëruara për Selefus Salih. Ato janë disa emra a emërtime të përdorura në fjalët e dijetarëve, me të cilat kanë ardhur argumentet. Një pjesë e tyre tregohet në argumente dhe është përdorur nga selefus-salih radijAllahu anhu.

Prej këtyre emërtimeve është: Ehlu Suneti dhe Xhemati, Ehlu Hadithi, Ehlu Etheri, Pala e ndihmuar, Grupi i shpëtuar, Gurabatë.

Emërtimi me Ehlu Suneti dhe Xhemati; Shejhu i Islamit Ahmed ibn Abdil-Halim ibn Tejmijeh el-Harranij, Allahu e mëshiroftë, në “Istikameh” ka thënë:

“Kështu, Suneti është i shoqëruar me bashkim, sikurse bidati është i shoqëruar me përçarje. Pra thuhet Ehlu Suneti dhe të bashkuarit në të, sikurse thuhet Ehlu bidati dhe të përçarjes.”

Gjithashtu, ai - Allahu e mëshiroftë - në një vend tjetër siç gjendet në Mexhmua në përkufizimin që i bën Ehlu Sunetin thotë:

“Janë ata të kapurit në Librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe në atë që ishin dakord të mëparshmit të parët, prej muhaxhirëve dhe

ensarëve dhe ata që i pasuan me përsosmëri.” Këtu mbaron fjala e tij, Allahu e mëshiroftë.

Emërtimi me Ehlu Hadithi dhe Ehlu Ether gjendet në fjalën e dijetarëve. Në fjalën e Imam Ahmedit, të Buhariut e shumë e shumë të tjerë, që tregojnë për këtë. Imam Ibn Tejmijeh, Allahu e mëshiroftë, në Mexhmu’a ka thënë:

“Ruga e selefëve, Ehlu Hadithi, i Sunetit dhe i Xhematit... dhe sjell rrugën.” I quajti Ehlu Hadithi, i Sunetit dhe i Xhematit.

Imami Hafidh Ebu Hatim Er-Rrazi thotë:

“Prej shenjave të bidatçijve është të flasin kundër Ehlu Etherin.”

Hatibi, Allahu e mëshiroftë, në Sheref As’habi Hadithi ka nxjerrë me sened të saktë nga Ahmed ibn Sinan el-Kattan se ka thënë:

“Nuk ka në dynja bidatçi, veçse e urren Ehlu Hadithin. Njeriu kur bën bidat i hiqet ëmbëlsia e hadithit prej zemrës së tij.”

Emërtimi me Grupi i shpëtuar dhe Pala e ndihmuar është transmetuar në hadithin e njohur, hadithin për përçarjen. “Janë përçarë jehudët në shtatëdhjetë e një grupe, janë përçarë të krishterët në shtatëdhjetë e dy grupe, dhe do të përçahet umeti im në shtatëdhjetë e tre grupe. Të gjithë do të jenë në zjarr, përveç njërit.” Ky është hadith i njohur, i famshëm, i saktë, ndryshe nga çka imagjinon dikush për pasaktësinë e tij.

Gjithashtu, është transmetuar në hadithin e Muauijes të lartpërmendur: “Do të jetë një grup prej umetit tim i ndihmuar me të vërtetën,” Hadithi.

Hafidhi Lalikai në “Sherhu Iëtikadi Ehli Suneh uel Xhemaah” ka thënë:

“Ajo është pala e ndihmuar dhe grupi i shpëtuar, është grupimi i udhëzuar dhe xhemati i drejtë, të kapur pas Sunetit.” Vështro tek këto cilësi të shquara e të mëdha!

Shejhu i Islamit Ibn Tejmijeh në hyrje të “Uasitijes” thotë:

“E më pas: Ky është besimi i grupit të shpëtuar e të ndihmuar deri Ditën Kijametit, Ehli Sunetit dhe Xhematit.”

Shejhu i Shujhëve tanë i nderuari Hafidh el-Hakemi, Allahu e mëshiroftë, në Meaarixh thotë:

“Ka ardhur lajmi i besnikut, të besuarit se grupi i shpëtuar janë ata që janë sipas asaj që ka qenë ai dhe shokët e tij radijAllahu anhum.”

Po ashtu, emërtimi “Guraba” ka ardhur në hadithin e njohur për gurabat:

“Tuba është (një pemë në Xhenet) për gurabat!” Hadithi.

Imam Eth-Theuri, Allahu e mëshiroftë, ka thënë:

“Përkujdesuni për Ehli Sunetin, përkujdesuni për Ehli Sunetin, sepse ata janë gurabat.”

Imam Ibnul Kajjim në “Medarixh” duke shpjeguar hadithin e gurbes thotë:

“Besimtarët në mesin e popullit islam janë guraba, dijetarët në mesin e besimtarëve janë guraba, dhe Ehli Suneti, ata që e dallojnë atë (sUNETIN) nga tekat dhe bidatet, në mesin e tyre janë guraba. Thirrësit tek ai (suneti), duruesit ndaj dëmtimeve që u sjellin kundërshtarët e tij janë më guraba nga të tjerët, por që këta janë njerëzit e Allahut në të vërtetë dhe për ta nuk ka gurbe... e deri sa thotë: ..., por që njerëzit e kësaj gurbe janë njerëzit e Allahut në të vërtetë, sepse ata nuk i janë drejtuar dikujt, përveç Allahut, e nuk i janë referuar përkatësisht tek dikush, përveç tek i Dërguari i Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, dhe nuk kanë thirrur, përveç se tek ajo me të cilën ai erdhi... e deri sa thotë: ..., por Islami i vërtetë me të

cilin erdhi i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe shokët e tij, sot ai është akoma më i huaj se sa në fillim të shfaqjes së tij.” Po flet për kohën e tij radijAllahu anhu.

“Islami me të cilin erdhi Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe ecën në të shokët e tij, sot ai është akoma më i huaj, apo sot ai është më i huaj se sa në fillim të shfaqjes së tij, ndonëse shenjat e mëdha të tij janë të dukshme, të njohura. Pra, Islami i vërtetë është më se i huaj. Islami i vërtetë është më se i huaj. Madje njerëzit e tij janë më se të huaj në mesin e të tjerëve.” Këtu mbaron fjala e tij, Allahu e mëshiroftë.

Të dashur! Pika e katërt: Gjykimi i pasimit të selefizmit dhe i përkatësisë me të. Pasimi i selefizmit dhe përkatësia me të.

Të dashur! Unë them: Çdo musliman që i drejtohet Kibles për t’iu falur Allahut në namazet farz apo nafile, lexon edhe suren El-Fatiha, që është shtyllë për të në farz apo nafile, lexon në të fjalën e Allahut:

﴿أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ٦﴾

“Na udhëzo në rrugën e drejtë!” El-Fatiha, 6.

I lutet Allahut që ta udhëzojë në rrugën e drejtë.

Po cila është kjo rrugë e drejtë, për të cilën i lutemi Allahut të na udhëzojë në të?

Përgjigja: Fjalët e dijetarëve janë të përafërta për kuptimin që ajo ka. Imam Ebul-Alijeh er-Rijahi e sjell të thjeshtuar për ty; **Imam Ibn Xheriri në Tefsir ka nxjerrë me sened hasen**, se një burrë e pyeti Ebul-Alijeh: Cila është rruga e drejtë, në fjalën e Tij:

﴿أَهْدِنَا الصِّرَاطَ الْمُسْتَقِيمَ ٦﴾

“Na udhëzo në rrugën e drejtë!”? Ai i tha:

- Rruga e drejtë është i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe dy shokët e tij më pas, Ebu Bekri dhe Umeri.

Largohet pyetësi dhe shkon tek Imam Hasani dhe i thotë: Ebul-Alijeh thotë kështu e ashtu. Pra, cili është mendimi yt? Ai i thotë:

- Të vërtetën ka thënë, dhe ka këshilluar.

A dëshiron të të udhëzoj Allahu në rrugën e drejtë?! Përmbaju Sunetit të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe përmbaju Sunetit të shokëve të tij, rrugës së sahabëve pas tij, që në krye të tyre janë zotërinjtë, halifët e drejtë, e në krye të tyre është Ebu Bekri dhe Umeri, - Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë ata.

Imam Ibn Kudameh, Allahu e mëshiroftë, në librin e tij “Dhemmit-Te’uil” thotë:

“... sepse ai sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është në rrugën e drejtë, prandaj kushdo që ndjek rrugën e tij, me patjetër që ka ndjekur rrugën e Allahut.”

Është detyrë për ne pasimi i tij, të qëndrojmë aty ku ai ka qëndruar, të heshtim ndaj asaj që ai ka heshtur.

Cili është gjykimi i pasimit të rrugës së tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe pasimi i rrugës së shokëve të tij Allahu qoftë i kënaqur me ta? Është uaxhib-detyrë, e nuk ka shmangie nga kjo. Është uaxhib, e nuk ka shmangie nga kjo. Argumentet e këtij uaxhibi janë të shumtë në Kuran dhe në Sunet, po të meditoje.

Imam Ibnul Kajjim ka vendosur një temë të dobishme në “I’lamul muukki’in” për obligueshmërinë e pasimit të kuptimit të Selefëve.

Le të përmendim disa argumente, prej tyre është fjala e Allahut të Lartësuar:

﴿وَإِنْ جُهِدَاكَ عَلَىٰ أَنْ تُشْرِكَ بِي مَا لَيْسَ لَكَ بِهِ عِلْمٌ فَلَا تُطِعْهُمَا ۖ وَصَاحِبُهُمَا فِي الدُّنْيَا مَعْرُوفًا ۖ وَاتَّبِعْ سَبِيلَ مَنْ أَنَابَ إِلَيَّ ثُمَّ إِلَيَّ مَرْجِعُكُمْ فَأُنَبِّئُكُمْ بِمَا كُنْتُمْ تَعْمَلُونَ﴾
﴿١٥﴾

“E nëse ata të dy (prindërit) tentojnë që ti të më bësh Mua ortakëri në adhurim, për çka ti nuk ke kurrfarë dije, (sepse për Të nuk ka ortakëri), atëherë mos iu bind atyre (në këtë), po në çështjet e dynjasë (në të cilat nuk ka kundërshtim të Zotit tënd) të jesh i sjellshëm me ta. E ndiqe rrugën e atij që është i kthyer tek Unë (që është penduar nga shirku, është kthyer tek Islami dhe ka ndjekur Muhamedin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem), pastaj kthimi juaj do të jetë tek Unë, e do t’ju njoftoj për atë që keni punuar (e do t’ju shpërblej për ç’ka keni vepruar në dynja).” Lukman, 15.

Imam Ibnul-Kajjim - vini re - , sepse është prej kuptimit të thellë që nuk e arrijnë veç ata që duruan - thotë:

“Çdo sahabi është i kthyer tek Allahu i Lartësuar. Kështu që është uaxhib pasimi i rrugës së tij, i fjalëve të tij, veprave të tij dhe besimeve të tij, janë ndër më e madhja rrugë e tij. Argumenti që ata janë të kthyer më përkushtim në adhurim është se Allahu i Lartësuar i ka udhëzuar.” I ka udhëzuar me Islamin dhe pasimin e të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, prandaj. “...është se Allahu i Lartësuar i ka udhëzuar. Allahu thotë:

﴿وَيَهْدِي إِلَيْهِ مَن يُنِيبُ﴾ ١٣

“Dhe e udhëzon për tek Ai, këdo që i drejtohet (bindjes së Tij).” Shura, 13.

Ky është prej kuptimit të thellë.

Të dashur! Gjithashtu, prej argumenteve është fjala e të Lartësuarit:

﴿قُلْ هَذِهِ سَبِيلِي أَدْعُو إِلَى اللَّهِ عَلَى بَصِيرَةٍ أَنَا وَمَنِ اتَّبَعَنِي وَسُبْحَانَ اللَّهِ وَمَا أَنَا مِنَ الْمُشْرِكِينَ ١٠٨﴾

“Thuaj (O Muhammed): “Kjo është Rruga ime; unë ftoj për tek Allahu (tek dëshmia se Nuk ka të adhuruar me të drejtë, përveç Allahut) në dije të sigurt, unë dhe kushdo që më ndjek mua. Unë dëshmoj se i pastër dhe larg çdo gjëje që ata adhurojnë është Allahu, dhe unë nuk jam prej mushrikëve.” Jusuf, 108.

Imam Ibnul Kajjim, Allahu e mëshiroftë, thotë:

“Allahu lajmëron se kush ndjek të Dërguarin e Tij, fton për tek Allahu. Dhe kush fton për tek Allahu me dije, është uaxhib pasimi i tij - sepse ai fton për tek dija - është uaxhib pasimi i tij, për fjalën e Allahut të Lartësuar duke treguar për xhinët dhe u kënaq me të:

﴿يَقَوْمَنَا أَجِيبُوا دَاعِيَ اللَّهِ وَءَامِنُوا بِهِ﴾

“O populli ynë, përgjigjuni thirrësit të Allahut (Muhamedit) dhe besoni në të!” El-Ahkaf, 31.

Edhe për shkak se ai që fton për tek Allahu me dije, ka ftuar tek e vërteta, duke e ditur atë. Thirrja për tek dispozitat e Allahut, është thirrje për tek Allahu, sepse ajo është thirrje për bindje ndaj Tij në atë që ka urdhëruar e atë që ka ndaluar.

Sahabët, Allahu qoftë i kënaqur me ta, e kanë pasuar të Dërguarin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, atëherë, është detyrë pasimi i tyre, sepse ata kanë ftuar për tek Allahu.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمَنْ يَعْتَصِم بِاللَّهِ فَقَدْ هُدِيَ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ١٠١﴾

“E kush i përmbahet fesë së Allahut, e i mbështetet Atij, ai, pa dyshim, është i udhëzuar në rrugën e drejtë.”
Al Imran, 101.

Imami Ibnul-Kajjim ka thënë: “Argumentimi me këtë ajet duket në atë që Allahu i Lartësuar ka lajmëruar për ata që janë kapur pas rrugës së Tij, se janë të udhëzuar në të vërtetën.”

Prandaj themi se sahabët, Allahu qoftë i kënaqur me ta, janë kapur pas bindjes së Allahut, janë të udhëzuar. Pasimi i tyre është uaxhib, detyrë.

Allahu i Lartësuar thotë:

﴿وَمَنْ يُشَاقِقِ الرَّسُولَ مِنْ بَعْدِ مَا تَبَيَّنَ لَهُ الْهُدَىٰ وَيَتَّبِعْ غَيْرَ سَبِيلِ الْمُؤْمِنِينَ
نُؤَلِّهِ مَا تَوَلَّىٰ وَنُصْلِهِ جَهَنَّمَ ۖ وَسَاءَتْ مَصِيرًا ۝١١٥﴾

“Kush i kundërvihet të Dërguarit, pasi që i është bërë i qartë udhëzimi (dija me të cilën erdhi i Dërguari) dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve (ixhmanë, kuptimi i tre brezave të parë të mirë), do ta lëmë në atë që ai ka zgjedhur dhe do e djegim në xhehennem. E sa vendqëndrim i keq është ai!” En-Nisa, 115.

Hafidh, Imam Ibn Kudameh në “Dhemmit-Te’uil” thotë:

“Tema e dytë rreth qartësimit se është detyrë pasimi i tyre dhe nxitja për t’iu përmbajtur rrugës së tyre dhe ndjekja e udhës së tyre, duke e qartësuar këtë nga Kurani dhe Suneti dhe nga fjalët e imamllarëve.

Për sa i përket prej Kuranit, - dhe përmend ajetin në suren Nisa që cituam. Më pas thotë:

- Ai ka kërcënuar, të ndiqet rrugë tjetër, veç rrugës së tyre, me dënimin e Xhehenemit. E u ka premtuar pasuesve të tyre kënaqësinë dhe Xhenetin, ku thotë:

﴿وَالسَّابِقُونَ الْأَوَّلُونَ مِنَ الْمُهَاجِرِينَ وَالْأَنْصَارِ وَالَّذِينَ اتَّبَعُوهُمْ بِإِحْسَنٍ رَضِيَ اللَّهُ عَنْهُمْ وَرَضُوا عَنْهُ﴾

“Të mëparshmit, të parët, prej Muhaxhirëve dhe prej Ensarëve dhe prej atyre që i pasuan ata me përsosmëri, Allahu është i kënaqur ndaj tyre (me bindjen që i bënë dhe që iu përgjigjën të Dërguarit) dhe ata janë të kënaqur ndaj Tij (me shpërblimin që morën për bindjen dhe imanin e tyre).”

Ai i ka premtuar pasuesve të tyre me përsosmëri atë që i ka premtuar atyre; prej kënaqësisë së Tij, Xhenetit të Tij dhe fitores së madhe.

Pejgamberi në hadithin e njohur të Irbad ibn Sarijes thotë:

“... Kapuni pas Sunetit tim dhe Sunetit të hulefave të drejtë, të udhëzuar. Kapuni pas saj me dhëmballët. Ruajuni nga shpikjet në fe, ...” e deri në fund të hadithit. Hadithin e kanë nxjerrë autorët e suneneve dhe është i saktë.

Imam Ibnul Kajjim ka thënë:

“E lidhi rrugën e Hulefave të tij me rrugën e vet, urdhëroi për ndjekjen e saj, ashtu siç ka urdhëruar për ndjekjen e rrugës së tij, duke e theksuar më tepër urdhrin sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, saqë urdhëroi të kapet në të me dhëmballë. Kjo përfshin atë për të cilën ata kanë dhënë fetva dhe e kanë bërë rrugë të ndiqet për umetin.” Këtu mbaron fjala e tij, Allahu e mëshiroftë.

Sikurse ju thashë, argumentet janë të shumtë.

E për sa i përket përkatësisë me të, ti mësove se pasimi i saj është uaxhib për ty pa diskutim, kështu që përkatësia me të është nderim.

Për këtë Imam ibn Tejmijeh, Allahu e mëshiroftë, ka thënë:

“Nuk është turp për atë që e shfaq rrugën e selefëve, dhe përkatësinë me të, që i referohet asaj, përkundrazi është detyrë për të ta pranoi këtë, sepse rruga e selefëve nuk është veçse e vërteta.”

Ty që të është dhënë suksesi, nëse do të meditoje; unë them: ty që të është dhënë suksesi, nëse do të meditoje në porositë e imamllarëve do të gjeje se ata të porosisin për pasim të rrugës së selefus-salih, Allahu qoftë i kënaqur me ta. Prej tyre po sjell një transmetim:

Imam El-Euzai, imami popullit të Shamit, Allahu e mëshiroftë, ka thënë:

“Përmbaje veten tënde në Sunet, qëndro aty ku ata kanë qëndruar, fol me atë që ata kanë folur dhe ndalo ndaj asaj që ata janë ndalur, ndiqe rrugën e të parëve të tu të mirë, sepse do të mjaftoi ty ajo që u ka mjaftuar atyre.” Mbaroi thënia e tij, Allahu e mëshiroftë dhe e faltë.

Ai që mediton në librat e Sunetit, në ato që i janë përkushtuar atij, do të gjejë tekste të shumta në porosi të tij.

Të dashur! Pika e pestë është Vlera e Pasimit të Selefizmit dhe Selefëve.

Kush i përmbahet selefizmit dhe menhexhit të selefëve me të vërtetë, kush i përmbahet me të vërtetë dhe me besnikëri, ka arritur tërë të mirën dhe ka arritur shpërblimin e

madh e të bollshëm, sepse ai i është përmbajtur udhëzimit të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Prej këtyre do të përmendim disa nga vlerat dhe virtytet:

- **Kush i përmbahet kësaj rruge ka ndjekur urdhrin e të Adhuruarit.** Dhe kjo gjë është prej asaj që e do Allahu dhe është i kënaqur.

Të dashur! Cili është adhurimi? Është emër që përfshin çdo gjë që e do Allahu dhe është i kënaqur me të prej fjalëve dhe veprave të dukshme dhe të padukshme. Kush i përmbahet atyre urdhëresave që i përmendëm, ka ndjekur urdhrin e Allahut. Dhe kush ndjek urdhrin e Allahut e do Allahu. A nuk është kështu?!

Gjithashtu prej veçorive dhe virtyteve:

- **Arritja e udhëzimit dhe siguria nga devijimi dhe humbja.** Argument për këtë është fjala e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem tek **Sahihu i Muslimit:**

“Kam lënë tek ju, atë çka nuk do të humbisni nëse i përmbaheni atij; Librin e Allahut.”

Por çfarë është në Librin e Allahut? A nuk është në Librin e Allahut urdhri për pasimin e të Dërguarit të Allahut dhe të të parëve të mirë të këtij umeti?! Kush i përmbahet, kapet pas kësaj, udhëzohet.

﴿وَمَنْ يَعْصِمْ بِاللَّهِ فَقَدْ هُدِيَ إِلَى صِرَاطٍ مُسْتَقِيمٍ ١٠١﴾

“E kush i përmbahet fesë së Allahut, e i mbështetet Atij, ai, pa dyshim, është i udhëzuar në rrugën e drejtë.”
Al Imran, 101.

Prej veçorive dhe virtyteve:

- **Mbrojtja dhe siguria nga rënia në kundërshtim të urryer dhe nga grupi i urryer.**

Të dashur! Tekstet e dy shpalljeve janë shumë. Ato urdhërojnë dhe nxisin për bashkim e pajtueshmëri në bazë të së vërtetës, me të dhe për të.

﴿وَأَعْتَصِمُوا بِحَبْلِ اللَّهِ جَمِيعًا وَلَا تَفَرَّقُوا﴾

“Dhe kapuni që të gjithë për Litarin e Allahut, e mos u përçani!” Ali Imran, 103.

Dhe thotë i Lartë-Madhëruari:

﴿وَلَا تَكُونُوا مِنَ الْمُشْرِكِينَ ۚ ۳۱ مِنَ الَّذِينَ فَرَّقُوا دِينَهُمْ وَكَانُوا شِيعًا﴾

“E mos u bëni nga idhujtarët. Të cilët e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe.” Er-Rrum, 31-32.

Në hadithin e Irbadit, që sapo e cituam, erdhi fjala e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

“... sepse ai që do të jetojë prej jush do të shohë kundërshtime të shumta.”

Po cila është mbrojtja, o i Dërguari i Allahut? Cili është shpëtimi? Cila është rruga e shpëtimit? Iu përgjigj:

“është detyrë për ju të kapeni pas Sunetit tim dhe Sunetit të hulefave të drejtë të udhëzuar.” Hadithi.

Imam El-Begaiu në “Sherhus-Suneh” ka thënë: “Në të tregon për shfaqjen e bidateve dhe te tekave. Allahu e di më së miri.

Pra, urdhëroi t’i përmbaheni Sunetit dhe Sunetit të Hulefave të drejtë, të kapeni pas kësaj në më të plotën formë të vullnetit e të sakrificës dhe të largoheni prej asaj që është shpikur në kundërshti me të.

Kërkon shpëtimin? Kërkon suksesin? Përmbahu. Sikurse ia tha këtë i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem atij burri:

“E mësove, atëherë, përmbahu.” Edhe ti përmbahu.

Të dashur! Gjithashtu prej veçorive dhe virtyteve:

- Largimi prej rrugëve të shejtanit dhe mbrojtja kundër shejtanit.

Allahu i Madhëruar në lartësimin e Tij thotë:

﴿وَأَنَّ هَذَا صِرَاطِي مُسْتَقِيمًا فَاتَّبِعُوهُ وَلَا تَتَّبِعُوا السُّبُلَ فَتَفَرَّقَ بِكُمْ عَنْ سَبِيلِهِ﴾

“Dhe se kjo (që porositë është feja që e pëlqeu për robërit e Tij) është rruga Ime e drejtë (që nuk ka devijim nga e vërteta), pra ndiqeni atë (veproni me të dhe bëjeni rrugë tuajën). E mos ndiqni rrugët e tjera (të shpikurat dhe dyshimet), e t’ju ndajnë nga rruga e Tij (nga Islami, me të cilin Pejgamberët porositën popujt e tyre).” El-En’am, 153.

Ibn Nasr El-Mer’uezi, Allahu e mëshiroftë, në “Suneh” ka thënë:

“Allahu ka lajmëruar se rruga e Tij është një e drejtë dhe se rrugët tjera janë shumë, të cilat e pengojnë këdo që i ndjek ato nga rruga e Tij e drejtë; - kuptimi i “Rrugës së drejtë” ka kaluar më parë. Më pas e ka sqaruar atë i Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem me Sunetin e tij, - ka për qëllim rrugën e drejtë. Dhe përmend hadithin e vijës. Ndoshta, ju e dini përmendësh. **Hadithin e Ibn Mes’udit, radijAllahu anhu, ku gjendja më e paktë e tij është hasen.** Imam El-Mer’uezi vijon të thotë:

- Allahu na ka paralajmëruar, më pas i Dërguari i Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem nga gjërat e shpikura dhe nga tekat penguese ndaj pasimit të urdhrit të Allahut dhe Sunetit të të Dërguarit të Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.”

Atëherë, ti nëse nuk i bindesh, nuk i përmbahesh kësaj, a ke humbur apo nuk ke humbur? Ke humbur. Allahu na ruajt.

Nëse i përmbahesh, sigurohesh. E kush i përmbahet, ka shpëtuar.

Të dashur! Gjithashtu, prej vlerave:

-Ai që është kapur pas kësaj rruge e i përmbahet asaj, do të ketë shpërblimin e atyre që e kanë pasuar. Sikurse, ka ardhur tek Sahihu i Muslimit:

“Kush vepron në Islam një vepër të mirë, ka shpërblimin e saj dhe shpërblimin e atyre që punuan me të, pa iu pakësuar asgjë prej shpërblimeve të tyre.”

Nëse thërret në të vërtetën dhe për të vërtetën, për ty do të jetë i gjithë shpërblimi.

Mirë! Po ai që pengon nga kjo rrugë dhe nga ky menhexh i vërtetë, a shpërblehet apo bën gjynah?! I kërkojmë mbrojtje Allahut nga humbja!

Të dashur! Gjithashtu prej veçorive dhe virtyteve:

-Pasha Allahun! Kush i përmbahet asaj me besnikëri, arrin shpërblimin e dynjasë dhe të ahiretit. Arrin shpërblimin e dynjasë dhe të ahiretit, sepse ka pasuar urdhrin e Allahut dhe urdhrin e të Dërguarit të Allahut. Pasuesi i urdhrin të Allahut dhe urdhrin të Dërguarit të Allahut është i shpëtuar, i lumtur.

Imam Ibnul Kajjim në librin e tij “Et-Tebukijeh” thotë:

“Bindja ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij, dhe gjykimi tek Allahu dhe tek i Dërguari i Tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është shkaku i lumturisë në të shpejtën dhe në të mëvonshmen, - në ahiret.

Kushdo që mediton në botën dhe në sherret që gjenden në të, mëson se çdo e keqe - kujdes, vë re - çdo e keqe në botë, shkaku i saj është kundërshtimi i të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe dalja nga bindja e tij, gjithashtu, çdo e

mirë shkaku i saj në botë është për shkak të bindjes ndaj të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.” Më pas thotë:

“E tillë është edhe me sherret në ahiret, me dhimbjet në të, me dënimin e saj, të gjitha këto janë bërë hak për shkak të kundërshtimit të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe në varësi të asaj që kërkon.

Pra, u kthye e keqja e dynjasë dhe e ahiretit tek kundërshtimi i të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe në atë që rrjedh prej këtij (kundërshtimi).

Sikur njerëzit t’i bindeshin të Dërguarit, ashtu siç ai e meriton bindjen, nuk do të ekzistonte në dynja asgjë e keqe!

Ashtu sikurse është e ditur për sherret e përgjithshme dhe fatkeqësive të rëna në tokë, e tillë është në sherrin, dhimbjen dhe brengosjen që e kaplon robin në veten e tij, kjo ndodh për shkak të kundërshtimit të tij ndaj të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

Bindja ndaj tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem është kështjella që kush futet në të do të jetë prej të mbrojturve, dhe ajo është shpella që kush strehohet tek ajo do të jetë prej të shpëtuarve.

Pra, bëhet e ditur se sherret e dynjasë dhe të ahiretit; është padituria e asaj me të cilën erdhi i Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem dhe dalja nga ajo.

Ky është fakt i prerë, se për robin nuk ka shpëtim dhe as lumturi, veçse në përpjekje për të njohur atë me të cilën erdhi Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.”

Pasha Allahun! Nuk ka lumturi për ty dhe as shpëtim, veçse në përpjekje për të njohur atë me të cilën erdhi Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, me dije dhe zbatim të kësaj dije duke e vepruar.

Mirëpo, këtu vëmë në dukje diçka me rëndësi, dhe bëjmë një përkujtim, sepse përkujtimi i bën dobi besimtarëve.

Jo çdokush që pretendon selefizmin është i sinqertë. Jo çdokush që ngre shenjat dalluese të selefizmit dhe pasimin e selefus-salih është i sinqertë. Pra, i sinqertë në pretendimin e tij.

Të dashur! Ky nuk është ngushtim, kurrsesi, pasha Allahun! Por përkundrazi, kush i pretendon ato, është detyrë e tij të veprojë me kuptimin e këtyre cilësive fisnike.

Imami Ibnul-Kajjim thotë: “Pasi u shtuan pretenduesit e dashurisë, iu kërkua të sillnin argumentin, - sepse jo çdokujt i pranohet padia, - iu kërkua të sillnin faktin të vërtetë saktësinë e pretendimit. Se nëse njerëzve do u jepej sipas pretendimeve të tyre, do të pretendonte ai që se lodh mendjen trishtimin e të pikëlluarit.

Pretenduesit u shfaqën në shumë forma gjatë dëshmisë, atëherë u është thënë: Kjo dëshmi nuk pranohet pa argument. Cili është argumenti?

﴿قُلْ إِنْ كُنْتُمْ تُحِبُّونَ اللَّهَ فَاتَّبِعُونِي يُحْبِبْكُمُ اللَّهُ وَيَغْفِرْ لَكُمْ ذُنُوبَكُمْ﴾

“Thuaj (o Muhamed): Nëse jeni që e doni Allahun, atëherë më pasoni mua (që të vërtetoni dashurinë tuaj që keni për Zotin), që t’ju dojë Allahu dhe t’ju falë gjynahet tuaja.” Al-Imran, 31.

Të gjitha krijesat u zmbarsën dhe qëndruan vetëm pasuesit e të Dashurit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, qëndruan vetëm pasuesit e të Dashurit sal-lAllahu alejhi ue sel-lem në fjalët e tij, në veprat dhe në moralet e tij.” Këtu mbaron fjala e tij, Allahu e mëshiroftë.

Prandaj, mos shih e mos u habit nëse dëgjon dikë që ngre disa shenja të rrejshme të kota. Siç është slogani “selefizmi-luftarak”, apo “xhemati selefij për thirrjen dhe luftën”, apo

“shoqata selefije e dijes”, e të ngjashme slogane, janë futje dhe anëtarësime në thirrjet e njerëzve të tekave, që ngjasojnë si penda pendës në fundin e shigjetës.

Imam Haseni jep porosi, - ki kujdes - ku thotë:

“O biri i Ademit! Mos u mashtro me fjalën e atij që thotë: Njeriu është bashkë me atë që e do.” Ky është hadith i saktë, mutefekun alejhi, mirëpo disa njerëz mendojnë se kjo mjafton, ndërkohë fjalët dhe besimet e tij janë të gjitha në kundërshtim. Mos u mashtro! Ai thotë:

“Ai që e do një popull, i ndjek gjurmët e tyre. Nuk do të bashkohesh me të devotshmit, derisa të ndjekësh gjurmët e tyre. Të marrësh udhëzimin e tyre, të pasosh sunetin e tyre, të gdhish e të ngrysesh, e ti të jesh në menhexhin e tyre. I preokupuar të jesh prej tyre, ecën rrugës së tyre, merr udhën e tyre, ndonëse mund të jesh i mangët në punë. Dije se thelbi i çështjes është të jesh i kapur pas bindjes. A nuk i ke parë jehudët, e të krishterët si edhe njerëzit e tekave poshtëruese se si ata i duan Pejgamberët e tyre, ndonëse nuk janë me ta, sepse i kundërshtuan në fjalën dhe veprën, ndoqën rrugë tjetër jo të tyren, kështu që përfundimi i tyre u bë zjarri. I kërkojmë mbrojtje Allahut prej kësaj.

I nderuari Ebul Mudhaffer Es-Sem’ani, Allahu e mëshiroftë, në transmetimin e Ibn Tejimijes prej tij, se ka thënë në “Saunil-Mentik”:

“Në jemi urdhëruar për pasim, e jemi ftuar në të, dhe jemi ndaluar nga shpikja, e jemi qortuar prej saj. Shenja e Ehli

Sunetit është pasimi i tyre i selefus-salih dhe lënia e çdo shpikjeje dhe bidati.”

Atëherë, jo çdokush që ngre shenjat dalluese është i sinqertë.

Ibn Tejmijeh ka thënë: “Ne nuk kemi për qëllim me “Ehlu Hadith” ata që mjaftohen me dëgjimin e tij, apo me shkrimin e tij, apo me transmetimin e tij, por kemi për qëllim me ta, çdokënd që është i denjë për mësim përmendësh të tij, për njohjen e tij, kuptimin e tij në të dukshmen dhe në të padukshmen, dhe pasimin e tij si haptazi ashtu edhe fshehtazi.”

Ndoshta, ju keni dijeni për atë që ndodhi në këtë vend të begatë, në fillim të shekullit katërmëdhjetë, për mizorinë e disa mendjelehtëve në Xhaminë e Shenjtë, Qaben. E dini këtë!

Ndër shkrimet e Shejhut tonë Muhammed Eman në revistën e Universitetit Islam, i cili ka qenë kryeredaktori i saj, ka thënë:

“Ezani i parë pas ngjarjes - pas pastrimit të Xhamisë së Shenjtë - konsiderohet lajm i përfundimit të fitnes, dhe i trishtimeve e i pikëllimeve që i mbarti, vendin e tyre e zuri lumturia dhe gëzimi, gëzimi me mirësinë e Allahut, mirësia e fuqisë në pastrimin e xhamisë së pastër nga ajo që ndodhi në të prej veprave të xhuhejmanive mendjelehtë.

Këtu është një çështje, e cila ka rëndësinë e saj, duhet theksuar:

Ata djelmosha mendjelehtë përdornin për vetet e tyre, sipas asaj që më ka ardhur për ta, se janë selefij. Sa e rëndë është fjala e dalë nga gjuhët e tyre! Ata, nuk thonë veçse gënjeshtër!

Përdorimi që ata i bëjnë këtij emri për vetet e tyre nuk del jashtë dy gjërave:

E para: Ata, ose nuk e njohin kuptimin e saktë të selefizmit, kështu që përdorimi i këtij emri nga ana e tyre rrjedh nga injoranca, që mund të jetë e përbërë¹;

Gjëja e dytë: Ose synojnë humbjen e të tjerëve; kështu që përdorimi ka qenë si pasojë e qëllimit të keq për të përlyer këtë emër të dashur, i cili ka për qëllim brezin e parë të këtij umeti dhe këdo që ndjek rrugën e tyre.

Atëherë, le ta mësoi lexuesi i nderuar, se xhuhejmanitë nuk janë selefij, dhe nuk janë të denjë për thirrje, por shtiren si selefij, pretendojnë selefizmin, pretendojnë se bëjnë thirrje në Islam, ndërkohë, ata janë larg Islamit, e aq më tepër nga thirrja në të.”

Çështja e gjashtë

Përmendja e disa shenjave dhe veçorive dalluese të këtij menhexhi të begatë dhe të kësaj thirrje të begatë, davetin selefij.

Kemi theksuar, se ajo është rruga e drejtë. Është ajo, të cilën kush e ndjek, shpëton, dhe kush e braktis, humb. Allahu na mbrojt!

Unë do i përmbledh për ty këto veçori. A dëshiron t'i njohësh veçoritë e kësaj thirrjeje dhe të këtij menhexhi? Pse selefizmi? Dhe çfarë është selefizmi? Frytet e kapjes pas saj?

Frytet e kapjes pas saj me singeritet dhe me drejtësi janë frytet e thirrjes së të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue

¹ “Injoranca e përbërë është arritja e një gjëje në të kundërt me atë që ajo është në realitet”. Shih: “Shpjegimi i Tre Bazave”, të Shejh Muhamed ibn Salih El-Uthejmin, faqe: 18. Përkthyesi.

sel-lem, për këdo që është kapur pas saj, ashtu si ka qenë, ashtu si ka vazhduar, e për tek çfarë është udhëzuar.

Prej shenjave dalluese të këtij menhexhi të begatë, prej veçorive të tij do të përmend në disa pika, duke nënvizuar sipas rastit të kërkuar.

Prej shenjave dalluese dhe veçorive të këtij menhexhi të vërtetë për atë që i përmbahet me sinqeritet:

E para: Realizimi i adhurimit për Allahun e Madhëruar, të Lartin; veçimin e Tij me Teuhid, të pastër adhurimin për Të, pa e përzier me shirk.

E dyta: Realizimi i veçimit me pasim të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem.

E treta: Kapja pas kuptimit të Selefus-Salih, radijAllahu anhum për argumentet e sheriatit, dhe mos dalja nga kjo.

E katërta: Ruajtja dhe paralajmërimi nga bidati dhe bidatçijtë.

E pesta: I mesëm, pa anime, me të drejtën, është kushdo që i përmbahet këtij menhexhi. I mesëm ndërmjet tejkalimit të kufijve dhe indiferentizmit.

E gjashta: Qëndrueshmëria në të vërtetën.

E shtata: Përkujdesja në bashkimin dhe afrimin në të vërtetën dhe me të vërtetën.

E teta: Flakja e përçarjes dhe e mosunitetit.

E nënta: Përkujdesja në arritjen e dijes së dobishme, përhapja e saj midis njerëzve dhe thirrja e tyre tek ajo, me durim ndaj vështirësive në këtë.

E dhjeta: Të vepruarit me dijen.

Të dashur! Argumentet e këtyre veçorive janë shumë për atë që mediton. Unë kam përmendur, në këtë leksion, me shumë se një herë hadithin e Irbad ibn Sarijeh radijAllahu anhu. Kushtoji vëmendje bashkë me mua! Allahu të dhëntë bereqet.

- I Dërguari sal-lAllahu alejhi ue sel-lem i ka porositur në fillim me devotshmërinë për Allahun. Kush i përmbahet kësaj porosie - kam për qëllim devotshmërinë për Allahun - me të drejtë, dhe e kryen atë, sigurisht që në kryerjen e saj është realizimi i adhurimit për Allahut e Lartë-Madhëruar.

- Gjithashtu, në këtë hadith gjendet porosia me kapjen pas Sunetit të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. Në kryerjen e kësaj porosie është realizimi i veçimit me pasim të të Dërguarit të Allahut sal-lAllahu alejhi ue sel-lem. A nuk është kështu?!

- Në të gjendet urdhri për kapjen pas Sunetit të Hulefave. Zbatimi i kësaj është realizim i kapjes pas kuptimit të selefëve radijAllahu anhum.

- Në hadith është paralajmërimi nga bidatet. Zbatimi i këtij urdhri është paralajmërim e realizim i paralajmërimit dhe ruajtjes nga bidatet dhe bidatçijtë.

- Gjithashtu në të, në zbatim të tij është realizimi i të mesmes ndaj dy ekstremeve, ndërmjet tejkalimit të kufijve dhe neglizhencës.

Kush i përmbahet Sunetit sipas kuptimit të selefëve, ai është i mesëm midis dy skajeve të kundërta.

- Në të gjendet paralajmërimi nga përçarja e urryer dhe mos uniteti, nga fjala e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem: ***“do të shoh përçarje të shumta”***. Kush i përmbahet, është i siguar nga përçarjet e shumta. Kjo nënkupton urdhrin për bashkim dhe afrim në të vërtetën, me fjalën e tij: ***“Kapuni pas Sunetit tim.”***

Të dashur! Është e ditur se nuk mund të jetë zbatimi i këtyre kuptimeve, dhe shfaqja e këtyre vlerave, vetëm se me anë të dijes fetare të dobishme.

Imam Ibn Tejmijeh, Allahu e mëshiroftë, thotë:

“E mira dhe lumturia, rregulli dhe përsosmëria mblidhen në dy gjëra:

Në dijen e dobishme dhe veprën e mirë.”

Gjithashtu, prej argumenteve për këto veçori apo për disa, është hadithi i nxjerrë nga Muslimi në Sahih, fjala e tij sal-lAllahu alejhi ue sel-lem:

“Allahu pëlqen për ju tre dhe urren për ju tre: Pëlqen për ju që ta adhuronit, pa i bërë ortakëri në adhurimin e Tij; të kapeni të gjithë në litarin e Allahut e të mos përçaheni. Dhe urren për ju të merreni me ‘thuhet’ e ‘ka thënë’; pyetjet e shumta; dhe shpërdorimin e pasurisë.”

Imam Ahmedi shton në Musnedin e tij: ***“dhe të këshilloni atë që Allahu e ka vendosur prijes mbi çështjen tuaj.”***

Ibn Tejmijeh, Allahu e mëshiroftë, në Minhaxhus-Suneh duke komentuar Litarin e Allahut, ka thënë:

“Litari i Tij është komentuar me Librin e Tij, me Fenë e Tij, me Islamin, me sinqeritetin, me urdhrin e Tij, me besën e Atij, me bindjen e Tij, me Xhematin, që të gjitha këto janë transmetuar nga sahabët dhe pasuesit e tyre me përsosmëri deri Ditën e Gjykimit. Të gjitha janë të sakta. Kurani urdhëron për fenë Islame, kjo është besa e dhënë Atij, urdhri i Tij, bindja e Tij, dhe kapje pas të të gjithave; këtë e gjen tek xhemati (të bashkuarit në të vërtetën), feja e Islamit realiteti i tij është sinqeriteti për Allahun e Lartësuar.”

Imami Muhammed Ibn Abdul-Uehhab tek ky hadith thotë:

“Nuk ka ndodhur gabim në fenë e njerëzve, apo në dynjanë e tyre, veçse për shkak të shkeljes së këtyre të trejave apo në disa prej tyre .”

Kam thënë se prej veçorive të këtij Menhexhi është qëndrueshmëria në të, për atë që i përmbahet mbi bazë të dijes dhe me drejtësi.

Allahu i Madhëruari e i Larti thotë:

﴿الَّذِينَ أُخْرِجُوا مِنْ دِيَارِهِمْ بِغَيْرِ حَقٍّ إِلَّا أَنْ يَقُولُوا رَبُّنَا اللَّهُ وَلَوْلَا دَفْعُ اللَّهِ النَّاسَ بَعْضَهُمْ بِبَعْضٍ لَهْذَمَتْ صَوْمِعُ وَبِيعَ وَصَلَوْتُ وَمَسْجِدُ يُذَكِّرُ فِيهَا أَسْمُ اللَّهِ كَثِيرًا وَلَيَنْصُرَنَّ اللَّهُ مَنْ يَنْصُرُهُ إِنَّ اللَّهَ لَقَوِيٌّ عَزِيزٌ ٤٠﴾

“Ata, të cilët vetëm pse thanë: “Allahu është i Adhuruari ynë!” u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte. E sikur Allahu të mos i mbrapste njerëzit, disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin (në kohën e çdo të Dërguari) vend-faljet e ithtarëve të Librit, sinagogë, manastire, kisha, si edhe xhamitë që në to përmendet shumë Emri i Allahut. E Allahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, sepse Allahu është i Plotëfuqishëmi, Krenari i Gjithëpushtetshëm.” El-Haxh, 40.

Allahu i Madhëruari e i Larti thotë:

﴿يُنَبِّتُ اللَّهُ الَّذِينَ ءَامَنُوا بِالْقَوْلِ الثَّابِتِ فِي الْحَيَاةِ الدُّنْيَا وَفِي الْآخِرَةِ﴾

“Allahu i forcon ata që besuan në Fjalën e Qëndrueshme (në dëshminë La ilahe il-lAllah Muhamed Resulullah) në jetën e kësaj bote (me imanin në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij) dhe në Ahiret (po me Teuhidin dhe imanin në të Dërguarin, kur të pyeten në varret e tyre).” Ibrahim, 27.

Hudhejfe - Allahu, i Lartësuar, qoftë i kënaqur me të - ka thënë:

“Humbja është ta konsiderosh të mirë atë që e ke refuzuar dhe konsiderosh të keqe atë që e ke njohur të mirë. Ruaju nga dredhat në fe’, sepse feja e Allahut është një.”

E ndoshta ju e kujtoni - Allahu ju ruajt - qëndrimin e Imam Ahmedit, Imamit të Ehli Sunetit, i cili është torturuar në rrugë të Allahut, u torturua në rrugë të Allahut dhe që i qëndrueshëm. Është goditur me kamxhik - Allahu qoftë i kënaqur me të dhe e kënaqtë - dhe është torturuar në rrugë të Allahut, por nuk u kthye nga fjala e vërtetë. I qëndrueshëm në të vërtetën, Allahu qoftë i kënaqur me të.

Edhe Imam Ibn Tejmijeh - Allahu e mëshiroftë - është torturuar në rrugën e Allahut dhe qëndroi. Allahu qoftë i kënaqur me ta dhe i kënaqtë.

Qëndrueshmëria në të vërtetën është prej veçorive të këtij menhexhi, është cilësi e njerëzve të tij të sinqertë, që e njohin atë. Pasha Allahun! Kush lexon biografite të tyre dhe thellohet në jetën e tyre, do t’i shfaqet kjo gjë para syve.

Shih në biografinë e imam Muhamed ibn Ahmed ibn Sehl Er-Rremlij, Allahu e mëshiroftë. Ky imam është shembull - Allahu qoftë i kënaqur me të dhe e kënaqtë. Duroi në Sunet. U torturua në rrugë të Allahut me një torturë të madhe. Imam Dhehebiu në biografinë e tij në Sijer thotë:

“Hafidh Ebu Dherr ka thënë: E burgosi atë Benu Ubejd dhe e kryqëzoi se qëndroi në Sunet.

E kam dëgjuar Imam Darekutnin që përmendte Imam Er-Rremlij dhe qante. E përmendte dhe qante. - Kush duron ndaj asaj që duroi ai?! - E përmendte dhe qante, duke thënë: Ai tha para se ta kryqëzonin, ndërkohë që po e rripnin: Kjo është e shkruar në Libër.” Besimtar në gjykimin e Allahut dhe caktimin e Tij.

Ibn Ekfani pasi përmend historinë e rrjepjes së tij, thotë: “E rropi atë një jehudi, madje jehudi që e rropi u ndie keq për dënimin që i bëhej, iu dhimbs, saqë e vendosi hanxharin në zemrën e tij dhe e vrau, si mëshirë për të.” Ibn Ekfani pasi përmend historinë e rrjepjes së tij, thotë: “E rropën, - Allahu e mëshiroftë, - e mbështollën me byk dhe e kryqëzuan.” U kryqëzua për shkak të kapjes së tij pas Sunetit. Kush është ai që i bën ballë asaj që ai e ka përballuar, Allahu e mëshiroftë?!

Mbyllja

Prandaj, – të dashurit e mi – kjo është mbyllja, me të cilën e mbylлим. E mbylltë Allahu për ne dhe për ju me të mirë!

Kaloi me ne, në këtë udhëtim, pohime nga Suneti, të cilat e nxisin njeriun për kapjen pas Sunetit, që t’i përmbahet urdhrit të hershëm e të parë;

﴿فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ رَبِّهِ أَحَدًا﴾

﴿١١٠﴾

“Pra, kush shpreson takimin e Zotit të tij le të punoi vepra të mira (në përputhje me rrugën e Pejgamberit) e mos të shoqëroi në adhurimin e Zotit të tij askënd.” El-Kehf, 110.

Dhe thotë i Lartësuari:

﴿لَقَدْ كَانَ لَكُمْ فِي رَسُولِ اللَّهِ أُسْوَةٌ حَسَنَةٌ لِّمَن كَانَ يَرْجُوا اللَّهَ وَالْيَوْمَ الْآخِرَ﴾

﴿وَذَكَرَ اللَّهَ كَثِيرًا ۖ ٢١﴾

“Për ju është shembulli i mirë tek i Dërguari i Allahut (tek Suneti i tij), për atë që shpreson tek Allahu dhe në Ditën e Fundit, e që përmend shumë Allahun.” El-Ahzab, 21.

Imam Umer ibn Abdul-Aziz duke porositur një nga nëpunësit e tij, pasi e pyet për pasuesit e tekave, i përgjigjet:

“E më pas. Unë të porosis ty me devotshmërinë ndaj Allahut, të mjaftohesh në urdhrin e Tij, të ndjekësh rrugën e Tij dhe Sunetin e të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu alejhi ue sellem dhe të braktisësh atë që e kanë sajuar shpikësit.”

E deri në fund të porosisë së tij.

Imam Ibn Hibban thotë:

“Tek kapja pas Sunetit të Tij gjendet shpëtimi i plotë dhe gjithë mirësitë.

Nuk fiken kandilat e tyre dhe nuk hidhen poshtë argumentet e tyre.

Kush i bindet atij, ka shpëtuar dhe kush e kundërshton atë, është penduar.

Ai është kështjellë e mbrojtur dhe shtyllë e sigurt, vlera e tij është e qartë dhe litari i tij është i fortë.

Kush kapet pas tij, lumturohet dhe kush synon jashtë tij, shkatërrohet.

Ata që janë lidhur me të gëzojnë lumturinë në këtë jetë të shpejtë dhe që synohet arritja e gradës së tyre në të mëvonshmen.

Së fundi! Imam Ibnul Kajjim Allahu e mëshiroftë ka thënë:

“Rruga më e afërt për tek Allahu është kapja pas Sunetit, qëndrimi me të haptazi dhe fshehtazi, vazhdimësia në lutje tek Allahu, me dëshirën për Fytyrën e Tij, të Vetmin, me fjalët dhe veprat. Askush nuk ka arritur tek Allahu, veçse me këto të treja. Dhe askush nuk është larguar, veçse nga shkëputja prej këtyre apo prej ndonjëres.”

I lutemi Allahut, të Madhëruarit, Zotit të Arshit bujar, të na përforcojë ne dhe ju në Islam dhe Sunet. Të na e marrë

shpirtin jo të rënë në fitne. Të na bashkojë me të mirët. Ai është Bujari i madh.

Lëvdata, shpëtimi dhe bereqeti i Allahut qoftë për të Dërguarit e Allahut, dhe për familjen dhe shokët e tij, e për këdo që i ndjek ata me përsosmëri deri Ditën e Gjykimit.

